



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0950

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE Bek Fluids L.L.C., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pelet” me numër të prokurimit VU644-25-6185-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E VUSHTRRIË, më 12.11.2025 mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e Bek Fluids L.L.C., me nr. 2025/0950, e datës 24/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pelet”, me numër të prokurimit VU644-25-6185-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E VUSHTRRIË.
2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E VUSHTRRIË për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pelet”, me numër të prokurimit VU644-25-6185-1-2-1.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 09.07.2025 KOMUNA E VUSHTRRIË, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pelet”, me numër të prokurimit VU644-25-6185-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 37,100.00 €.

Me 12.09.2025 KOMUNA E VUSHTRRISË., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është anuluar aktiviteti i prokurimit

Me 17.09.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 18.09.2025 AK e ka hedhur si të jashtëaftshme kërkesën për rishqyrtim.

Me 24.09.2025, OE Bahri Asllani., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0950, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Bek Fluids L.L.C., janë parashtruar si në vijim:

ANKESË Autoriteti Kontraktues ka shpallur aktivitetin e prokurimit për “Furnizim me Pelet”, me vlerë të parashikuar 37,100 €, siç është publikuar në njoftimin për kontratë. Vetë publikimi i vlerës dëshmon se fondet ishin planifikuara dhe të alokuara në momentin e shpalljes, në përputhje me Nenin 9 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Procedura është zhvilluar normalisht deri në fazën e shpalljes së fituesit. Operatori Ekonomik (OE) i parë i renditur nuk i ka dorëzuar referencat brenda afatit të përcaktuar nga AK. Në bazë të Neneve 59 dhe 69 të LPP-së, kjo e bënte ofertën e tij të papërgjegjshme. Si OE i dytë i renditur, me ofertë të përgjegjshme dhe të plotë, ne prisnim shpalljen fitues në përputhje me ligjin.

Në vend të kësaj, AK vendosi të anulojë tërë aktivitetin, duke u thirrur në mungesë të fondeve. Ky vendim u mor vetëm pas kërkesës sonë për rishqyrtim dhe pas momentit kur ne dolëm fitues potencial. Pas kësaj, kërkesa jonë për rishqyrtim u refuzua nga AK me arsyetimin se ishte “jashtëafatshme”. Ky arsyetim nuk qëndron as ligjërisht, as faktikisht.

SHKELJET LIGJORE1.Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar brenda afatit ligjor

Neni 108/A i LPP-së dhe Neni 10.1 i Rregullores 001/2022 parashohin afatin ligjor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Neni 5 i LPP-së (Kalkulimi i afateve kohore) përcakton se dita e marrjes së njoftimit është “dita zero” dhe afati fillon të nesërmen.

AK e interpretoi gabimisht ligjin, duke e llogaritur ditën e njoftimit si ditën e parë, dhe padrejtësisht e shpalli kërkesën tonë jashtëafatshme.

2. Shkelja e Nenit 62 të LPP-së (Anulimi)

Ky nen lejon anulimin vetëm kur:

- (i) ekziston një shkelje ligjore e pakorrigjueshme;
- (ii) të gjitha ofertat përgjegjëse tejkalojnë buxhetin; ose
- (iii) para hapjes së ofertave ndodh një ngjarje objektive.

Asnjëra nga këto rrethana nuk qëndron në këtë rast.

3. Shkelja e Nenit 9 të LPP-së (Sigurimi i fondeve)

AK kishte obligim të siguronte fondet para shpalljes së tenderit. Pasi njëherë fondet u deklaruan publikisht, nuk mund të përdoren përbarimet apo ndryshimet e mëvonshme buxhetore si justifikim për mungesë fondesh.

4. Shkelja e Neneve 59 dhe 69 të LPP-së (Vlerësimi i ofertave)

OE i parë nuk përmbushi kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe duhej shpallur i papërgjegjshëm. Vendimi për anulim, në vend të shpalljes së OE të dytë fitues, përbën shkelje të qartë të dispozitave ligjore.

5. Shkelja e Nenit 7 të LPP-së (Barazia dhe Jo-diskriminimi)

AK eliminoi konkurrencën në mënyrë të padrejtë duke anuluar procedurën pikërisht në momentin kur ne u renditëm si fitues potencial.

6. Parimi i kontratave publike kornizë

Ligji përcakton se kontratat publike kornizë nuk janë obligative për shfrytëzim në mungesë buxheti. AK mund të mos e aktivizonte kontratën, por nuk kishte bazë ligjore ta anulonte aktivitetin e prokurimit.

ARBITRARITETI I VENDIMIT

Fondet ishin deklaruar publikisht në vlerën 37,100 €.

Fituesi u shpall mbi këtë bazë ligjore dhe buxhetore.

Vetëm pas kërkesës sonë për rishqyrtim, AK shpalli “mungesën e fondeve”.

Nëse fondet me të vërtetë mungonin, anulimi duhej bërë para hapjes së ofertave, jo pas shpalljes së fituesit potencial.

Vendimi është i pakuptimtë, arbitrar dhe i qëllimshëm për të na dëmtuar si OE pjesëmarrës.

KËRKESA

Në bazë të sa më sipër, kërkojmë që OSHP të:

Shfuqizojë vendimin e AK për hedhjen e kërkesës sonë si jashtëafatshme.

Konstatojë se vendimi për anulim është i paligjshëm dhe në kundërshtim me nenet 7, 9, 59, 62 dhe 69 të LPP-së.

Urdhërojë Autoritetin Kontraktues të vazhdojë procedurën e prokurimit dhe të shpallë fituesin sipas renditjes ligjore.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ri-vlerësimit të tenderëve ka marrë vendim që, për shkak se informatat financiare në ndërkohë kanë ndryshuar materialisht, fakt i cili është konfirmuar edhe përmes Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktueshmërisë së Disponueshmërisë së Fondeve, të anulojë aktivitetin e prokurimit me arsyetimin sikurse është saktësuar në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, si dhe njoftimi letër për tenderuesit, janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. 12.09.2025, bazuar në dispozitat e nenit 42, paragrafi 42.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), në tekstin e mëtejme Rregullore nr. 001/2022.

Autoriteti Kontraktues, pasi ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim, fillimisht ka shqyrtuar afatshmërinë e Kërkesës për Rishqyrtim në zbatim të nenit 42 të Rregullores nr. 001/2022. Lidhur me këtë, A.K. ka konstatuar se Kërkesa e O.E. "Bek Fluids L.L.C." është parashtruar jashtë afatit ligjor të saktësuar si në nenin 42.7 të Rregullores nr. 001/2022, citat: "Nëse njoftimi publikohet ditën e premte, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte sepse dita e premte është ditë pune." (mbarim i citatit).

Sikurse ka konstatuar A.K., Kërkesa për Rishqyrtim tek A.K. përmes platformës elektronike është dorëzuar – parashtruar më dt. 17.09.2025, ndërsa afati i fundit për dorëzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nga O.E., ashtu sikurse është saktësuar në nenin 42.7 të Rregullores nr. 001/2022, citat: "Nëse njoftimi publikohet ditën e premte, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte sepse dita e premte është ditë pune." (mbarim i citatit), është pesë (5) ditë nga data e publikimit të njoftimit, që i bie se data e fundit për parashtrim të Kërkesës për Rishqyrtim është data 16.09.2025.

Andaj, rrjedhimisht ky afat nga ankuesi nuk është respektuar dhe, për pasojë, Kërkesa për Rishqyrtim është konsideruar dhe vërtetuar si e parashtruar jashtë afatit ligjor prej pesë (5) ditëve nga data e publikimit të njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, në kuptim të zbatimit të nenit 42.7 të Rregullores nr. 001/2022, dhe për rrjedhojë Kërkesa për Rishqyrtim, në pajtim me dispozitat e nenit 42.7 lidhur me nenin 60 të Rregullores nr. 001/2022, është hedhur poshtë.

Bazuar në nenin 60, paragrafi 60.2 të Rregullores nr. 001/2022, është përgjegjësi e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim që kërkesa të përgatitet dhe të dërgohet në Autoritetin Kontraktues para skadimit të afatit të fundit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim.

Nëse parashtruesi dështon të përgatisë dhe paraqesë kërkesën për rishqyrtim brenda afateve kohore, përgjegjësia e dështimit mbetet tek parashtruesi i kërkesës.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 26.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0950, ndërsa me datë 17.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0950, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa te mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK për anulim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Bek Fluids L.L.C., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0950 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1 Pretendimi i parë ankimore sipas ankesës 950/25 ka të bëjë me arsyen e AK-së për hudhje sit ë jashtë afatshme të kërkesës për rishqyrtim , ku sipas AKs-ë pas njoftimit mbi vendimin e AK-së me 12.09.2025, OE ankues me 17.09.2025 (sipas AK-së jashtë afatit ligjore prej 5 ditë) ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, Citat nga vendimi i AK-së:

“Autoriteti Kontraktues pasi ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim, fillimisht ka shqyrtuar afatshmërinë e Kërkesës për Rishqyrtim në zbatim të nenit 42 të Rregullores nr. 001/2022. Lidhur me këtë A.K. ka konstatuar se Kërkesa e O.E. "Bek Fluids L.L.C. " është parashtruar jashtë afatit ligjorë të saktësuar si në nenin 42.7 të Rregullores nr. 001/2022, citat : " Nëse Njoftimi publikohet ditën e premte, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte sepse: Dita e premte është ditë pune " mbarim i citatit.”.

OE ankues pretendon se kërkesa për rishqyrtim është në pajtim dhe Brenda afateve ligjore të parashikuara me nenin 108/A të LPP-së dhe nenit 5 të LPP-së :

“Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar brenda afatit - Neni 108/A i LPP-së dhe Neni 10.1 i Rregullores 001/2022 parashohin afatin ligjor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim. - Neni 5 i LPP-së (Kalkulimi i afateve kohore) thekson se dita e marrjes së njoftimit është “dita zero”. Afati fillon të nesërmen. - AK e interpretoi gabim ligjin duke e llogaritur ditën e njoftimit si ditën e parë dhe padrejtësisht e shpalli kërkesën jashtëafatshme”.

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se AK gabimisht i është referuar rregullores të vitit 2022, pasi në fuqi është rregullorja 02-2024.

Megjithatë edhe me rregullores e viti 2024 neni 42.7 është i njëjtë me atë të vit 2022. Si do që të jetë, neni 42.7 i rregulores përcakton se :

” 42.7 Nëse njoftimi publikohet në ditën e premte, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte sepse:

a. Dita e premte është ditë pune.

b. Në përputhje me Nenin 60, paragrafi (b) të kësaj rregullore, data e njoftimit është “dita 0” e 5 ditëve.

Bazuar në këtë dispozitë të, nëse data 12.09.2025 është dita zero, atëherë data 17.09.2025 është dita e pestë, rrjedhimisht vlerësojmë se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar Brenda afatit ligjorë dhe se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimi nr.2 Lidhur me arsyen e anulimit të aktiitetit të prokurimit, OE pretendon se :

“2. Shkelja e Nenit 62 të LPP-së (Anulimi) Ky nen lejon anulimin vetëm kur: (i) ka një shkelje ligjore të pakorrigjueshme, (ii) të gjitha ofertat përgjegjëse tejkalojnë buxhetin, ose (iii) para hapjes së ofertave ndodh një ngjarje objektive. Asnjëra nuk është e vlefshme këtu. 3. Shkelja e Nenit 9 të LPP-së (Sigurimi i fondeve) AK kishte obligim të siguronte fonde para shpalljes. Pasi njëherë fondet u deklaruan, nuk mund të përdoren përmbarimet e mëvonshme si justifikim. 4. Shkelja e Neneve 59 dhe 69 të LPP-së OE i parë nuk përmbushi kriteret ? duhej shpallur i papërgjegjshëm. Vendimi për anulim në vend të shpalljes së OE të dytë fitues është shkelje e qartë. 5. Shkelja e Nenit 7 të LPP-së (Barazia dhe Jo-Diskriminimi) AK eliminoi konkurrencën në mënyrë të padrejtë duke anuluar procedurën pikërisht kur ne dolëm fitues potencial. 6. Parimi i kontratave publike kornizë Ligji përcakton se kontratat publike kornizë nuk janë obligative për shfrytëzim në mungesë buxheti. AK mund të mos e aktivizonte kontratën, por nuk kishte bazë ligjore ta anulonte aktivitetin”.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës , në veçanti të deklaratës së nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve të publikuar me 11.09.2025, neni 3 SHQRYTIMI ku kërkohet Deklarata e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim të kontratave para publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së, me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht, është plotësuar me PO, dhe është nënshkruar nga tre personat përgjegjës të AK-së, si ZPP, ZKF dhe ZKA me referim në raportin FB, duke i bashkangjitur deklaratës edhe njoftimin nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe financa se :

“Njoftim Ju njoftoj edhe njëherë siq jeni ne dijeni ne bazë të nenit 40 të LMFP-se, Thesari do të ekzekutojë obligimet përmbare edhe nga alokimi i të hyrave vetanake and pa konfirmimin e mjeteve buxhetore nga Drejtoria e Financave ju lutemi që të mos iniconi lidhjen e kontratave pa mjete financiare. Shtojc; Rapori i Mallrave dhe shërbimeve nga FB”.

Duke pas përsyshe të gjitha këto që u cekën më lart, në këto rrethana përderisa kemi konfirmim nga drejtoria e buxhetit dhe financave të AK, pas së cilës është nënshkruar edhe deklarata e nevojave neni 3 për informacionet e modifikuara, eksperti shqyrtues rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues KOMUNA E VUSHTRRIË lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pelet”, me numër të prokurimit VU644-25-6185-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - Bek Fluids L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: